



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1347 / Prot.

Patos më, 25 / 06 / 2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 35, datë 25.06.2025

MBI MIRATIMIN E BLERJES SË MJETIT “AUTOBETONIERE PËR NEVOJAT E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 54, pika “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, V.K.B nr. 87, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025”, kërkesës së Agjencisë së Shërbimeve Publike për blerje mjet pune, autobetoniere nr. 534 prot., datë 24.06.2024, Ekipi i programit të menaxhimit të rrugë rurale,

KËRKON:

1. Të miratohet blerja e mjetit “Autobetoniere për nevojat e Agjencisë së shërbimeve publike”, me vlerë 5,000,000 (pesë milion) lekë.
2. Financimi i koston së këtij mjeti, do të bëhet nga fondi i çliruar nga prokurimi i objektit “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit, lagja e Re.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

RRUGË RURALE

Drejtues të Programit

Ermenita MICI

ENEO XHAFERI

ANËTARËT
Silvana MICI

Boreta MURATI

JURISTE
Nurkë HAZIZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 1947/2 Prot.

Patos më, 25/06/2025

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

**MBI MIRATIMIN E BLERJES SË MJETIT “AUTOBETONIERE PËR
NEVOJAT E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE”**

Bashkia e Patos në kuadër të shtrirjes së investimeve me disa projekte njëkohësisht në të gjithë territorin po përballlet me vështirësi që kanë të bëjnë me prodhimin dhe transportimin e betonit në kantiere. Aktualisht prodhimi i betonit realizohet me anë të betonierëve me kapacitet 0.25m³, të cilat sigurojnë sasi shumë të ulët betoni në krahasim me kërkesat që agjencia duhet të plotësojë për kryerjen e punës. Shërbimet e mirëmbajtjes dhe ndërtimit të infrastrukturës (rrugë, trotuare, kanale kulluese, kanalizime të ujërave të bardha dhe të zeza, mure mbajtëse, etj.) kërkojnë sasi të konsiderueshme betoni i cili nuk mund të sigurohet dhe prodhohet me mjete me kapacitet të ulët. Ky proces shoqërohet me vonesa në kryerjen e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve e për rrjedhojë kërkon një numër më të madh punëtorësh të pozicionuar në një front pune. Nga ana tjetër agjencia përballlet po ashtu me problematikat që lidhen me vështirësitë logjistike për shkak të distancave të ndryshme të kantierëve dhe transportit të betonit pranë tyre.

Blerja e një mjeti autobetoniere ka për synim përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e kapaciteteve të ndërhyrjes në infrastrukturën rrugore dhe ndërtimore. Me anë të saj agjencia e shërbimeve publike do të ketë mundësi të prodhojë dhe transportojë betonin në kohë reale, në çdo zonë të territorit të bashkisë pa vonesa, duke ulur në këtë mënyrë kostot operative dhe duke sjellë realizimin e projekteve në një kohë më të shkurtër.

Ekipi i programit rrugë rurale duke parë situatën dhe ecurinë e punimeve që agjencia e shërbimeve duhet të realizojë ka vlerësuar si të domosdoshme blerjen e një autobetoniere e cila do të sigurojë prodhimin e betonit në një kohë më të shkurtër duke ofruar sa më shpejt shërbimet e munguara komunitetit.

Për blerjen e këtij mjeti është parashikuar përdorimi i një fondi me vlerë 5,000,000 (pesë milion) lekë.

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratohet blerja e mjetit “Autobetoniere për nevojat e Agjencisë së shërbimeve publike”, me vlerë 5,000,000 (pesë milion) lekë.
2. Financimi i koston së këtij mjeti, do të bëhet nga fondi i çliruar nga prokurimi i objektit “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit, lagjja e Re.
3. Për ndjekjen e zbatimin e projekt vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Shërbimeve, Agjencia e Shërbimeve Publike.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT


RRUGË RURALE

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**



ENEO XHAFERI



ANËTARËT

Boreta **MURATI**



Silvana **MICI**



KRYETARI

Fation Duro

